



Planuar / Doretuar Primitur / Prifatur Received / Delivered	05.11.20	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	2455/2020		112



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.311/2020

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Avdyll Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.311/2020 të datës 20.10.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë rr."Sinan Morina", pa nr. në Komunën e Klinës, kundër organit të punësimit-Komuna e Klinës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 05.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. PËRFUNDON procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.311/2020 të datës 20.10.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED]

II. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED] i punësuar si nëpunës civil në Komunën e Klinës, më datë 20.10.2020 nëpërmjet e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është protokolluar me Nr. Prot:2165/2020, me pretendimet ankimore për mos plotësimin dhe ndryshimin e të dhënave personale në sistem duke mos përfshirë nostrifikimin e diplomës së nivelit master i arteve në administratë publike dhe diplomaci.

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.10.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Klinës. Më datë 02.11.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Klinës.

Ankuesi [REDACTED] nëpërmjet e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net më datë 02.11.2020 ka parashtruar kërkesë për tërheqje të ankesës me arsyetim se: *"...Komuna e Klinës e ka përmbushur obligimin e saj, pra më datë 30.10.2020 ma ka dhënë një kopje të ndryshimplotësim të aktit të emërimit"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e datës 20.10.2020 me Nr. Prot:2165/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 20.10.2020 nga ankuesi ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Komunikimet e ankuesit me Xhavit Dauti të datës 14.10.2020; Kërkesën për tërheqje të ankesës e datës 02.11.2020; Fletëdërgesën e datës 30.10.2020 nga Komuna e Klinës për ankuesin; Ndryshim dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 30.10.2020 dhe përgjigja në ankesë e datës 02.11.2020 nga Komuna e Klinës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi më datë 20.10.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mirëpo pas lëshimit të Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të Emërimit të datës 30.10.2020 nga Komuna e Klinës për ankuesin, ankuesi më datë 02.11.2020 nëpërmjet e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net më datë 02.11.2020 ka parashtruar kërkesë për tërheqje të ankesës me arsyetim se: *"...Komuna e Klinës e ka përmbushur obligimin e saj, pra më datë 30.10.2020 ma ka dhënë një kopje të ndryshim-plotësim të aktit të emërimit"*, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse ankuesi ka bërë tërheqjen e ankesës së datës 20.10.2020, atëherë objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e tij është bërë i pamundur sipas nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.311/2020, datë 05.11.2020

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Klinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.